



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova**  
**Republic of Kosovo**



**Komuna e Kaçanikut**  
**Opština Kaçanik**  
**Municipal Kaçanik**  
**-Shërbimi i kuvendit-**

## **KUVENDI I KOMUNËS KAÇANIK**

**SHËRBIMI PËR PUNË PROFESIONALE TË KUVENDIT**

# **BULETINI** **PËR AKTIVITETIN E KUVENDIT TË KOMUNËS** **01.01.2012- 31.12.2012**

**Kaçanik, 2013**

## **H Y R J E**

Ky Buletin përfshinë Aktivitetin e Kuvendit të Komunës së Kaçanikut, në periudhën kohore, 01.01.2012 - 31.12.2012.

Buletini është përpiluar nga Shërbimi për Punë Profesionale të Kuvendit të Komunës.

Bazë për përpilimin e këtij Buletini kanë shërbyer Procesverbalet e përpiluara gjatë punës së Kuvendit.

Qëllimi i këtij Buletini është pasqyrimi i aktivitetit të kuvendit të komunës për gjatë kësaj periudhës njëvjeçare, sistemimi i tyre dhe njoftimi i strukturave komunale në drejtim që të jetë sa më transparent aktiviteti i zhvilluar.

Shërbimi Profesional për Punë të Kuvendit është mirënjohës për vërejtjet dhe sugjerimet që do të jepen në të. Këto vërejtje dhe sugjerime do të ndihmojnë që aktiviteti në punën e ardhshme të jetë sa më i suksesshëm dhe cilësor.

## PËRBËRJA E KUVENDIT TË KOMUNËS

Kuvendi i Komunës së Kaçanikut i dalë në zgjedhjet e datës 15.11.2009, numëron gjithsej 27 anëtarë, dhe atë

<b>Nr. rend</b>	<b>Emri dhe Mbiemri</b>	<b>Pozita</b>
1.	Xhelal Gashi	PDK
2.	Ilaz Ceka	PDK
3.	Tefik Vishi	PDK
4.	Ramadush Osmani	PDK
5.	Afrim Bunjaku	PDK
6.	Kemajl Murseli	PDK
7.	Driton Thaqi	PDK
8.	Krenare Luzha	PDK
9.	Zekirja Loku	PDK
10.	Habib Guri	PDK
11.	Floriqe Dalloshi	PDK
12.	Arbnora Sallahu	PDK
13.	Diana Bajrami	PDK
14.	Shiqeri Luzha	AAK
15.	Shukri Luta	AAK
16.	Hajdar Loku	AAK
17.	Rami Çaka	AAK
18.	Sevdije Frangu	AAK
19.	Nerimane Lika	AAK
20.	Afërdita Deda	AAK
21.	Daut Rudi	LDK
22.	Ibrahim Hoxha	LDK
23.	Nazife Krasniqi	LDK
24.	Floriqeta Gashi	LDK
25.	Ali Krasniqi	AKR
26.	Sherife Troni	AKR
27.	Elife Murseli	LDD

Me Kuvendin e Komunës udhëheq z. Xhelal Gashi, kryesues i kuvendit.

Më këtë përbërje, Kuvend i Komunës Kaçanik, e ka vazhduar aktivitetin edhe në vitin 2012, me ndryshimin në spektrin politik, kështu që anëtari Shukri Luta nga subjekti politik i AAK, në vitin 2012 në kuvend vepron i Pavarur.

**Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF), ka këtë përbërje:**

<b>Nr. ren.</b>	<b>Emri dhe Mbiemri</b>	<b>subjekti</b>	<b>pozita</b>
1.	Xhelal Gashi	PDK	kryesues
2.	Zekirja Loku	PDK	anëtar
3.	Arbnora Sallahu	PDK	anëtare
4.	Kemajl Murseli	PDK	anëtar
5.	Shyqeri Luzha	AAK	anëtar
6.	Shukri Luta	AAK	anëtar
7.	Daut Rudi	LDK	anëtar

Në ndërkohë, përbërja e KPF-a pëson ndryshime, ashtu që me 31.01.2012 me Vendim të Kuvendit, anëtari Shukri Luta, zëvendësohet me anëtarin, Rami Çaka nga subjekti politik i AAK.

**Komiteti për Komunitete, është në përbërje:**

<b>Nr. ren.</b>	<b>Emri dhe Mbiemri</b>	<b>subjekti</b>	<b>pozita</b>
1.	Rami Çaka	AAK	anëtar
2.	Ibrahim Hoxha	LDK	anëtar
3.	Sherife Troni	AKR	anëtare
4.	Bahrije Çaka	shoqëria civile	anëtar
5.	Bislim Krasniqi	shoqëria civile	anëtar

**Ekzekutivi i komunës, kishte këtë përbërje:**

<b>Nr.</b>	<b>Emri dhe Mbiemri</b>	<b>Pozita</b>
1.	Xhabir Zharku	kryetar i Komunës
2.	Heset Loku	nënkryetar i Komunës
3.	Jeton Topalli	drejtor i Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme(DAP),
4.	Misim Sopa	drejtor i drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenies Sociale(DSHMS)
5.	Fikri Verbani	drejtor i drejtorisë për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim(DEFZH)
6.	Azem Guri	drejtor i drejtorisë për Arsim dhe Kulturë(DAK)
7.	Bekim Troni	drejtor i drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit(DUKMM)
8.	Rushan Ceka	drejtor i drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencë(DSHPE)
9.	Nuhi Provoliu	drejtor i drejtorisë për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari(DBZHRP)

Në ndërkohë kjo përbërje pëson ndryshime, pasi kryetari i Komunës së Kaçanikut, z. Xhabir Zharku me datë 11 maj të vitit 2012 ka ofruar dorëheqje nga posti i kryetarit të komunës.

Pas dorëheqjes së kryetarit të Komunës z. Xhabir Zharku, nënkryetari i Komunës, z. Heset Loku, ka punuar, kryetar në detyrë i komunës, deri me zgjedhjen e kryetarit të ri Besim Ilazi i cili zyrtarisht më 2 korrik mori pozitën e kryetarit të komunës së Kaçanikut. Po nga kjo datë (2 korrik), z. Heset Loku shkon në pozitë të re, respektivisht emërohet drejtor në Burgun e Lipjanit.

Kështu në ndërkohë me Vendim të Presidentes së Republikës së Kosovës, znj. Atifete Jahjaga, u shpallën Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Kaçanikut, më datë : 17. 06. 2012.

Në këto zgjedhje garuan për Kryetar të Komunës 5 kandidatë nga 5 subjekte politike dhe fituan votat, paraqitur si në tabelë;

**Tabela:**

<b>Nr. Rend.</b>	<b>Kandidatët</b>	<b>Subjekti</b>	<b>Nr.i votave të fituara</b>	<b>Numri i votave të fituara, shprehur në %.</b>
1.	Besim Ilazi,	PDK	5304	52,24%,
2.	Sahit Bela,	LDK	566	5.57%
3.	Tahir Çaka,	AAK	2033	20.02%
4.	Shukri Luta,	VV	1696	16.70%
5.	Kijani Berisha,	AKR	555	5.47%.

**Në bazë të rezultatit të votimit, në RUNDIN I të votimit, kandidati nga PDK, z. BESIM ILAZI, ka fituar numrin e mjaftueshëm të votave për të udhëhequr në komunën e Kaçanikut, në pozitën e kryetarit të Komunës.**

Betimin Solemn për kryetar komune, z. Besim Ilazi e ka dhënë në mbledhjen Solemne të kuvendit të komunës më datë: 02.07.2012.

Kryetari i zgjedhur i komunës në vitin 2012 nga zgjedhja e tij, e filloj aktivitetin e vet me drejtorët e drejtorive aktual, të cilëve më datë: 17.09.2012, iu ka lëshuar Vendime për emërimin e tyre në pozitat e përcaktuara, me të cilët ka punuar për gjatë tërë vitit 2012.

Me vendim të kryetarit të Komunës, 01Nr. 16-21049/2012 me datë: 14.08.2012, për nënkryetar komune emërohet, z. Remzi Elezi.

## **AKTIVITETI I KUVENDIT TË KOMUNËS**

### **Viti 2012 Mbledhja I**

Mbledhja e I Rregullt e Kuvendit të Komunës është mbajtur me datë: 31.01.2012, udhëhequr nga Xhelal Gashi, kryesues i kuvendit, janë marrë këto Vendime;

1. Vendimi për aprovimin e Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2012,
2. Vendimi për aprovimin e Raportit të Punës së Ekzekutivit të Komunës, për vitin 2011,
3. Vendimi për aprovimin e Planit të Veprimit për përmirësimin e shërbimit të shenjzimit rrugor,
4. Vendimi për bartjen e bilanceve të pashpenzuara nga të hyrat vetjake komunale të vitit 2010 dhe 2011, në vitin fiskal 2012 dhe
6. Vendimin për ndryshim plotësimin e Vendimit për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa, ashtu që nga KPF-a hiqet Shukri Luta dhe zëvendësohet me Rami Çaka nga subjekti politik i AAK.

### **Mbledhja II**

Mbledhja e II-të e Rregullt e kuvendit të komunës është mbajtur me datë: 29.02.2012, udhëhequr nga Xhelal Gashi, kryesues i kuvendit, janë marrë këto Vendime:

1. Vendimi për aprovimin e Raportit të Punës së Komitetit për Politikë dhe Financa, për vitin 2011,
2. Vendimi për aprovimin e Raportit Vjetor Financiar, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2011,
3. Vendimi për Hartimin e Planeve rregulluese për Zonat Turistike,
4. Vendimi për lirimin e bizneseve komunale nga taksat-ngarkesat vjetore për ushtrimin e veprimtarisë së tyre afariste.

### **Mbledhja III**

Mbledhja e III-të e Rregullt e kuvendit të komunës është mbajtur me datë: 04.04.2012, udhëhequr nga Xhelal Gashi, kryesues i kuvendit, janë marrë këto Vendime:

1. Vendimi për kufizimin e shërbimeve me pagesën e faturave për ujë,
2. Vendimi për kufizimin e shërbimeve me pagesën e faturave për mbeturina,
3. Nxirret Konkludim sipas të cilit Kuvendi i komunës Kaçanik, i mbështetë fuqishëm Vendimet: 01Nr. 173/2002, të datës 12.06.2001 dhe 01Nr. 35/04 të datës: 01.12.2003, të aprovuara nga kuvendi i komunës Kaçanik, për Kthimin e tokave në Çardak ish pronarëve ( në sipërfaqën e përgjithshme: 318.55,40 ha).

### **Mbledhja IV**

Mbledhja e IV-të e Rregullt e kuvendit të komunës është mbajtur me datë: 30.04.2012, udhëhequr nga Xhelal Gashi, kryesues i kuvendit, janë marrë këto Vendime:

1. Vendimi për aprovimin e Raportit financiar, për periudhën: janar-mars, 1012,
2. Vendimi për Riemërimin e pronës së paluajtshme komunale në të gjitha Institucionet: Arsimore, Shëndetësore dhe ish BVI-ve, që në librat kadastral janë evidentuar si Pasuri shoqërore, tani Riemërohen Pronë komunale e kuvendit të komunës Kaçanik / Lënda: 01Nr.16-8802/2012,
3. Vendimi për ndërrimin e pasurisë së paluajtshme, në mes të kuvendit të komunës Kaçanik dhe Tahire Memishi (e veja e Shabanit nga f. Elezaj), në Zonën Kadastrale Druaj-Gabrricë/ Lënda: 01Nr. 350-9162/2012.



## **Mbledhja V**

Mbledhja e V-të e Rregullt e kuvendit të komunës është mbajtur me datë: 30.05.2012, udhëhequr nga Xhelal Gashi, kryesues i kuvendit, janë marrë këto Vendime:

1. Vendimi për aprovimin e Rishikimin e Buxhetit të komunës për vitin 2012 /Lënda: 01Nr. 16-11525/12,
2. Vendimi për Aprovim të Rregullores për ndryshim plotësimin e Rregullores 01Nr.05-8253/10- Për përcaktimin e orarit të punës së subjekteve afariste në territorin e komunës së Kaçanikut.

## **INAGURIMI I KRYETARIT TË ZGJEDHUR TË KOMUNËS, BESIM ILAZI**

Mbledhja Inauguruese e kuvendit të komunës është mbajtur me datë: 02.07.2012, udhëhequr nga Xhelal Gashi, kryesues i kuvendit, është marrë ky Vendim:

1. Vendimi për Inaugurimin e kryetarit të zgjedhur të komunës së Kaçanikut, z. Besim Ilazi.

## **Mbledhja VI**

Mbledhja e VI-të e Rregullt e kuvendit të komunës është mbajtur me datë: 31.07.2012, udhëhequr nga Xhelal Gashi, kryesues i kuvendit, janë marrë këto Vendime:

1. Vendimi për Aprovimin e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve të Komunës së Kaçanikut për vitet 2013-2015, e e njëjta lëshohet në procedurën e debatit publik më qytetarë,
2. Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores 01Nr. 05-4236/2010 e tarifave dhe ngarkesave administrative dhe shërbimeve të tjera komunale, e datës: 27.07.2010, ashtu që të ;
  - Produktet kadastrale vlejné tarifat e përcaktuara si në UA 05/2012 e nxjerrë nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor më datë 11.06.2012.
  - Neni 11.1, e Rregullores, hiqet tarifa për vlerësimin e vlerës së kontratave të pasurisë së paluajtshme në vlerë 50€,
  - të neni 9.6.1, e Rregullores, hiqet tarifa 500€ në muaj për vendosjen e antenave, transmetuesve të ndryshëm , si telefonisë celulare, fikse, internetit etj, ndërsa mbetet në fuqi tarifa e përcaktuar në nenin 13.2 paragrafi 4, vendosja e antenave, transmetuesve të ndryshëm, në vlerë 10€.

**3.** Vendimin për Shfuqizimin e Vendimit të kuvendit të komunës 01Nr. 16-5980/12 të datës 04.04.2012, për kufizimin e shërbimeve me pagesën e faturave të Mbeturave ( për shkak të konstatimeve të MAPL së është në kundërshtim me Ligjet në fuqi të Republikës së Kosovës),

**4.** Vendimin për Shfuqizimin e Vendimit të kuvendit të komunës 01Nr. 16-6293/12 të datës 04.04.2012, për kufizimin e shërbimeve me pagesën e faturave të Ujit (për shkak të është konstatuar në MAPL së është në kundërshtim me aktet në fuqi të Republikës së Kosovës),  
dhe

**5.** Vendimin për Modifikimin e Vendimit 01Nr. 16-8802/12 i datës: 30.04.2012, që ka të bëjë me rrimërimin e pronës së paluajtshme komunale të institucioneve arsimore, enteve shëndetësore dhe ish BVI-të.

## **Mbledhja VII**

Mbledhja e VII-të e Rregullt e kuvendit të komunës është mbajtur me datë: 27.09.2012, udhëhequr nga Xhelal Gashi, kryesues i kuvendit, janë marrë këto Vendime:

**1.** Vendimin për miratimin e Buxhetit të komunës së Kaçanikut për vitin 2013 dhe vlerësimet për vitet, 2014-2015,

**2.** Vendimi për Aprovimin e Rregullores për vendosjen e tatimit në pronë në territorin e komunës së Kaçanikut, për vitin 2013,

**3.** Vendimi për ndryshimin e shumave të ndara për projektet kapitale sipas ndarjeve me buxhetin e komunës për vitin 2012,

**4.** Vendimin për emërtimin dhe rrimërimin e rrugëve lokale në komunën e Kaçanikut,

**5.** Vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e mini hidrocentraleve mbi lumin Lepenc,

**6.** Vendimin për Konsultim paraprak me MAPL për çështjen e shqyrtimit të ligjshmërisë për dhënie në shfrytëzim të përkohshëm-me qira këshillit të bashkësisë islame në Kaçanik, pronën e paluajtshme të komunës për ndërtimin e xhamisë në Kaçanik të Vjetër,

**7.** Vendimi për shpalljen në diskutim publik të Planit Rregullues të zonës së I-r dhe një pjese të zonës së II-të urbane dhe Planet Rregulluese të Zonave Turistike,

**8.** Vendimi për prolongimin e Propozim Vendimit për formimin e komisionit për vlerësimin e ofertave dhe për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale.

## **Mbledhja VIII**

Mbledhja e VIII-të e Rregullt e kuvendit të komunës është mbajtur me datë: 31.10.2012, udhëhequr nga Xhelal Gashi, kryesues i kuvendit, janë marrë këto Vendime:

- 1.** Vendimin për Aprovimin e Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane të komunës së Kaçanikut/ Lënda: 01Nr. 16-27322/12,
- 2.** Vendimin për formimin e Komisionit për zgjedhjen e Këshillave lokale, me këtë përbërje:
  1. Tefik Vishi, ( anëtar i kuvendit nga PDK-a ),
  2. Sevdije Frangu, ( anëtar i kuvendit nga AAK ),
  3. Ilir Teneqja, ( zyrtar komunal nga ekzekutivi i komunës )
  4. Shemsedin Abazi (përfaqësues nga shoqëria civile),
  5. Një Përfaqësues i fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane ( për secilin fshat, vendbanim apo lagje urbane).
- 3.** Vendimi për aprovimin Rregullores për caktimin e kritereve për ndarjen e subvencioneve dhe transfereve/ Lënda; 01Nr. 16-27192/12,
- 4.** Debatohet për Raportin nëntëmujor i buxhetit, për nëntëmujorin e përfunduar me 30 shtator 2012/ Lënda: 01Nr. 05-400-26576/12.
- 5.** Raporti i auditivit për pasqyrat vjetore financiare të komunës së Kaçanikut për vitin 2011 /Lënda: 01Nr. 16-27781/12.
- 6.** Vendimin për ndërrimin e destinimit të parcelave kadastrale për PZHU të Kaçanikut /Lënda: 01Nr. 16-350-27552/2012.

## **Mbledhja IX**

Mbledhja e IX-të e Rregullt e kuvendit të komunës është mbajtur me datë: 24.12.2012, udhëhequr nga Xhelal Gashi, kryesues i kuvendit, janë marrë këto Vendime:

- 1.** Vendimi për ndërrimin e destinimit të parcelave kadastrale për Planin Zhvillimor Urban(PZHU), të Kaçanikut,
- 2.** Vendimi për ndarjen e shumës 20.000€ për bursa të studentëve të komunës së Kaçanikut,për vitin 2012/2013,

3. Vendimi për caktimin e lokacionit për dhënien në shfrytëzim të pasurisë së paluajtshme për ndërtimin kolektiv të banimit, në parcelën kadastrale nr. 1356 e shënuar sipas certifikatës nr. 183 , zona kadastrale Kaçanik i Vjetër, e evidentuar në emër të kuvendit të komunës Kaçanik,
4. Vendimi për miratimin e planit rregullues( Zona turistike Malet e Sharrit), dhe
5. Informohet kuvendi për ndarjen e mjeteve buxhetore shtesë në shumë 200.000€ nga granti qeveritar.

### **Mbledhja X**

Mbledhja e X-të e Rregullt e kuvendit të komunës është mbajtur me datë: 28.12.2012, udhëhequr nga Xhelal Gashi, kryesues i kuvendit, janë marrë këto Vendime;

1. Vendimi për formimin e komisionit për ndarjen e bursave të studentëve të komunës së Kaçanikut,për vitin 2012/2013, në përbërje:
  1. Kemajl Murseli, anëtar i KK nga PDK,
  2. Florijeta Gashi, anëtare e KK nga LDK,
  3. Sherife Troni, anëtare e KK, nga AAK,
  4. Avni Kراسiqi, zyrtar komunal në DAK, dhe
  5. Afet Ceka. zyrtar komunal në DAK.
2. Vendimi për miratimin e Planit Rregullues Urban të Zonës së I-r dhe një pjesë të zonës së II-të të Kaçanikut.

## **MBLEDHJE SOLEMNE**

Kuvendi i Komunës së Kaçanikut, gjatë vitit 2012, ka mbajtur tri mbledhje me karakter Solemn dhe atë; me datë 17.02.2012, një mbledhje Solemne i kushtohet, Ditës së Pavarësisë së Kosovës. Me 11.06.2012, një mbledhje Solemne i kushtohet, Ditës së Çlirimit të Komunës dhe më datë 10 gusht 2012, një mbledhje Solemne i kushtohet, Ditës së Dëshmorëve të Komunës.

## **DEBATE PUBLIKE**

Kuvendi i Komunës së Kaçanikut, gjatë vitit 2012, ka organizuar dhe mbajtur Debate publike me qytetarë të komunës për çështje të përgjithshme, dhe për çështje të veçanta, si për Buxhetin e komunës dhe për çështje tjera më rëndësi për komunën.

## **MONITORIMI I MBLEDHJEVE**

Monitorimi i mbledhjeve të rregullta të kuvendit nga strukturat vendore është bërë nga MAPL-a, ndërsa nga strukturat ndërkombëtare, mbledhjet e rregullta të Kuvendit, janë monitoruar nga OSBE-a.

Përgatiti: Makfire Malsiu,  
Zyrtare e kuvendit